



**KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR**  
**НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЏИНЕ**  
**NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY**

Numër 254-01/24  
Data 26.03.2024  
Bujanoc

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr. 254-01/24, datë 26.03.2024, shpallim:

### **THIRRJE PËR BURSA STUDENTORE**

**Ftohen të gjithë studentët shqiptarë që jetojnë në Luginën e Preshevës, të aplikojnë për bursa studentore që Këshilli Kombëtar Shqiptar ndan në zbatim të Vendimit të qeverisë Nr. 08/L-260 nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi “Përkrahje për Luginën e Preshevës” me kod 39100, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.**

Për bursa studentore, do të përfshihen studentët e të gjitha niveleve (Bachelor, Master dhe Doktoraturë). Shuma e granteve për të gjitha nivelet do të varet nga nota mesatare (për vitin e parë, do të merret parasysh nota mesatare e shkollimit paraprak) dhe numri i aplikuesve pas marrjes së vendimit nga KKSH.

Kriteret e përzgjedhjes për nivelin Bachelor:

1. Përfshirja e të gjithë studentëve të rregullt;
2. Studentët e nivelit Bachelor deri në moshën 26 vjeç;
3. Kategorizimi sipas notës mesatare.

Kriteret e përzgjedhjes për nivelin Master dhe Doktoraturë:

1. Përfshirja e të gjithë studentëve;
2. Studentët e nivelit Master deri në moshën 26 vjeç;
3. Studentët e nivelit Master dhe Doktoraturë nuk duhet të jenë në marëdhënie pune.
4. Kategorizimi sipas notës mesatare.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen fizikisht në ambientet e selisë së Këshillit Kombëtar Shqiptar, në Rr. Karagjorgje Petroviq, nr. 237 gjatë orarit 09:00-15:00. **Afati i aplikimit është 01 Prill 2024-22 Prill 2024. Afati i fundit për aplikim është ora 15:00, datë 22.04.2024.**

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në [kksh.org](http://kksh.org) (website i KKSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në [kksh.grantet@gmail.com](mailto:kksh.grantet@gmail.com) ose na telefononi në nr. **0631408945**.

**Vërejtje:** Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen. Komisioni vlerësues pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve përpilon listën preliminare, e cila mund të ankimohet në shkallën e dytë nga aplikuesi, brenda një afati 8 ditor nga data e shpalljes së listës preliminare.

